VENDIM
Nr.742, datë 7.11.2007

PËR KRITERET E PËRZGJEDHJES SË NJËSIVE EKONOMIKE, QË DUHET TË ZBATOJNË STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "c" të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjekte të zbatimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit janë subjektet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 4 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar.

2. Njësitë e tjera ekonomike, të cilat nuk janë objekt i ligjit të sipërpërmendur, do të jenë subjekt i zbatimit të standardeve ndërkombëtare, kur tejkalojnë njëkohësisht, për dy vitet e fundit, këto kufij:

a) të ardhurat vjetore, në shumën 1 250 000 000 (një miliard e dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

b) numri mesatar i të punësuarve, mbi 100 punonjës në vit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për mbikëqyrjen e zbatimin e pikës 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha